



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština – Assembly***

---

Legjislatura VI  
Komisioni për Buxhet dhe Financa  
Mbledhja nr. 37/18  
Prishtinë, më datë 30.11.2018, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

**PROCESVERBAL**

Në mbledhjen morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Ali Lajçi, Arbërie Nagavci, Dardan Molliqaj, Enver Hoti dhe Blerim Kuçi.

Munguan: Jelena Bontic dhe Fikrim Damka.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku – Kryetar (tutje kryetari).

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i rendit të ditës;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe i amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes dhe i amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe i amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;**
- 6. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari:** Konstatoi se Komisionit unanimisht, miratoi rendin e ditës, pa ndryshime.

## **2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe i amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së**

**Kryetari:** Theksoi se e kemi thirrur këtë mbledhje të komisionit në mënyrë urgjente, për të shqyrtuar tri projektligjet dhe amendamentet e komisionit funksional lidhur me transformimin e FSK-së në Ministrinë e Mbrojtjes. Për ta thënë më thjeshtë në komision këtë vit nuk ka pasur ligje më të rëndësishme në aspektin e vlerësimit të kostos financiare sesa këto të tanishmet. Ne e kemi thënë edhe në seancë, kosto financiare të mjaftueshme nuk ka të parapara për transformimin e FSK-së në ushtri. Por ne si komision do ti trajtojmë dhe ti procedojmë tutje, dhe në momentin kur ka kërkesa shtesë buxhetore për ushtrinë e ardhshme të Kosovës do të gjejmë alternativa shtesë për ndarjen e mjeteve buxhetore. Për momentin Kosova i shpenzon 0.7% të bruto produktit të brendshëm për mbrojtje që është norma më e ulët në rajon dhe është gati tri herë më pak sesa një vend mesatar i NATO-së. Pra në të ardhmen, edhe në kornizën afatmesëm të shpenzimeve duhet të shohim mundësinë e dyfishimit të buxhetit për ushtrinë.

**Ali Lajçi:** Duke vlerësuar të rëndësishme procesin e transformimit të FSK-së në ushtri, këtyre tri projektligjeve, mungon qështja e trajtimit ushtarak si mision dhe ai bëhet nëpërmjet Kushtetutës. Megjithatë çdo tentim të dinamizimit, të forcimit madje të përparimit të FSK-së drejt një misioni ushtarak për mua është e mirëseardhur dhe e përkrahu fuqimisht. Ndërsa po të shikohet aspekti i aprovimit të projektligjeve pa një kosto financiare është problem faktikisht, por sidoqoftë ne për shkak të të rëndësishës së qështjes ne do ti mbyllim sytë dhe do të votojmë. Sa i përket amendamenteve të komisionit funksional, shifet se i kanë dhënë një fuqi të sensibilizimit apo të fuqizimit ndoshta të termeve që janë përdorur dhe me këtë propozime bukur iu ka afruar qështjes së rrugëtimit adekuat të terminologjisë, për çka i përgjigjen niveleve prej komunave dhe instancave të tjera, sidomos kur kemi të bëjmë me Shtabin e Përgjithshëm i cili është organi kryesorë i ushtrisë në këtë rast i FSK-së. Por sidoqë të jetë është për mirëseardhje dhe një vullnet i madh i shtyn përpara këtë forcë e cila ka shumë rëndësi në momente që Kosova të ketë një fuqi sigurie, civile madje edhe sigurim ushtarak.

**Kryetari:** Ushtria e Kosovës vitin e ardhshëm ka 53 milionë euro buxhet, në vitin 2020 do të ketë 57 milionë euro, ndërsa në vitin 2021 do të ketë 62 milion euro. Ky është parapara brenda Buxhetit të Republikës së Kosovës që trajtohet në Kuvend. Këto shuma përbëjnë 0.7% të bruto brutor produktit të brendshëm dhe dëshironim të kishim më shumë se kaq. Do të dëshiron që vitin e ardhshëm buxheti i FSK-së të jetë rreth 100 milionë euro, por me kërkesën dhe me kohë me trajtimin e kërkesave edhe komisioni do ti adresojë këto qështje.

**Safete Hadërgjonaj:** Më vjen mirë që sot i kemi në shqyrtim këtë pako të ligjeve për formimin e ushtrisë dhe sa i përket koston buxhetore, meqenë nuk janë të ngarkuar me koston financiare ne duhet ti kalojmë këto projektligje dhe ti bëjmë ligje. Ne kemi diskutuar gjatë shqyrtimit të buxhetit në lexim të parë, dhe Ministri i Financave, na ka sqaruar se fondi i kontigjencës i përfshirë në buxhet, është një mundësi që secili ligj i cili kërkon zbatueshmëri dhe mjete financiare, mund të shfrytëzohet ai fond dhe kështu që mund të themi se mjetet janë në buxhet, dhe mund të përdoren që në momentin e zbatueshmërisë së ligjit. Po ashtu, ne si Kuvend kemi të drejtë që kurdo që paraqitet nevoja, të miratojmë kërkesat buxhetore të cilat na vijnë nga institucione si rezultat i miratimit apo ndryshimit të ligjeve. Prandaj, mendoj se nuk besoj se do të ketë problem sa i përket koston buxhetore për zbatimin e këtyre ligjeve.

**Enver Hoti:** E ndajë mendimin me kryetarin se në këtë komision janë projektligjet më të rëndësishme që po shqyrtojmë, e që kanë të bëjnë me transformimin e FSK-së në Ushtrinë e Kosovës. Prandaj, është për të përshëndetur një vullnet i tillë politik. Mendoj që qeveria dhe ne si komision jeni të gatshëm në mundësinë e realizimit të çdo kërkesë buxhetore të cilat do të jenë për zhvillimin e mëtutjeshëm të

Kosovës dhe për plotësimin e misionëve të tyre dhe përgjegjësi që dalin për ushtrinë e ardhshme. Në mbështetje këto projektligje dhe përgëzojmë të gjithë qytetarët për ushtrinë e Kosovës, që do të jetë me kapacitete shtesë dhe Kosova do të njihet më mirë në fushën e sigurisë.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni, unanimisht nxori këtë

### **Rekomandim**

Projektligji nr.06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes dhe i amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së**

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni, unanimisht nxori këtë

### **Rekomandim**

Projektligji nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

### **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe i amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së**

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni, unanimisht nxori këtë

### **Rekomandim**

Projektligji nr.06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

**Mbledhja përfundoi në orën 13:20.**

**Përgatitur nga njësi mbështetëse e komisionit**

**Kryetari komisionit,**

-----

**Lumir Abdixhiku**